VENDIM
Nr. 953, datë 29.12.2014

PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 159, të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ligj", ligji nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".
2. "TVSH/tatimi", tatimi mbi vlerën e shtuar në kuptim të ligjit.
3. "Përjashtim", përjashtimi nga TVSH-ja sipas kuptimit të ligjit;
4. "OJF", organizatë jofitimprurëse sipas kuptimit të ligjit "Për organizatat jofitimprurëse".
5. "Zbritja e TVSH-së", e drejta për të zbritur TVSH-në për furnizimet e marra sipas kuptimit të ligjit.

Neni 2
Kriteret për zbatimin e përjashtimit për organizatat jofitimprurëse

Në zbatim të nenit 51, shkronjat "ë", "f", "i", "j", "k", përjashtohen nga TVSH-ja nëse plotësojnë kriteret dhe procedurën sipas këtij vendimi furnizimet e mëposhtme të kryera nga organizatat jofitimprurëse:

1. Furnizimi i shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me ndihmën dhe asistencën sociale, përfshirë veprimet që kryejnë shtëpitë e kujdesit për të moshuarit;
2. Furnizimi i shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve;
3. Furnizimi i shërbimeve të caktuara, të lidhura ngushtë me ushtrimin e sportit ose të edukimit fizik, që u ofrohen personave që marrin pjesë në ushtrimin e sportit apo të edukimit fizik;
4. Furnizimi i shërbimeve të caktuara kulturore dhe edukative, si dhe mallrave që lidhen ngushtësisht me to.

II. Kriteret për vlerësimin e qëllimit jofitimprurës të organizatës

Këto furnizime me karakter shoqëror, edukativ, kulturor, sportiv përjashtohen nga TVSH-ja kur kryhen nga organizma publikë apo nga organizata pa qëllim fitimi me karakter social, të njohura nga autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë dhe me çmime të miratuara nga ky autoritet. Në rast se këto çmime nuk janë të miratuara, veprimtaria e organizatës përfiton këtë përjashtim nga TVSH-ja, me kusht që çmimet e furnizimeve që ofron organizata jofitimprurëse të jenë më të ulëta se ato që ofrohen për furnizime të ngjashme nga ana e subjekteve të TVSH-së, me qëllim që të mos sjellë shtrembërim të konkurrencës.

Zbatimi i përjashtimit nga TVSH-ja kërkon të plotësohen tri kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

1. Organet drejtuese të organizatës nuk duhet të kenë interesa të lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë e organizatës.
2. Veprimtaria joekonomike (pa qëllim fitimi) e organizatës duhet të mbizotërojë dukshëm në raport me pjesën tjetër të veprimtarisë, duke marrë në konsideratë të ardhurat përkatëse, duhet të

kenë epërsi të ardhurat nga veprimtaria joekonomike e organizatës.

3. Furnizimet që kryhen nga organizatat jofitimprurëse nuk duhet të konkurrojnë sektorin tregtar fitimprurës. Shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike e organizatës si veprimtari dytësore e saj, e kryer prej këtyre organizatave për qëllime të veprimtarisë jofitimprurëse, për të cilën janë krijuar, të arkëtuara gjatë vitit kalendarik, nuk duhet të kalojë 20% të të ardhurave të përgjithshme vjetore të organizatës.

Nocioni i "të ardhurave të përgjithshme" përmbledh të gjitha burimet financiare të organizatës, përfshirë të ardhurat nga furnizimet dhe subvencionet e shfrytëzimit.

III. Organizmat që përfshihen sipas formës së organizimit të tyre

Organizmat që përfitojnë nga ky përjashtim kur plotësojnë kriteret e sipërpërmendura për veprimtarinë ekonomike që ato kryejnë janë:

-shoqatat me interes të përgjithshëm të organizuara në një formë, të tillë si organizatat politike, sindikaliste, profesionale, filozofike ose fetare, shoqatat kulturore, social-kulturore ose sportive, shoqatat folklorike etj;

-organizatat e krijuara sipas ligjit "Për organizatat jofitimprurëse", të cilat veprojnë pa qëllime fitimi, të tilla si fondacione, grupime të ndërvarura, komitete të ndryshme.

Këto organizata jofitimprurëse, që veprojnë në këtë mënyrë, përjashtohen për shërbimet me karakter social, edukativ, kulturor apo sportiv, si dhe për furnizimet e mallrave që u ofrojnë me çmime të reduktuara kryesisht anëtarëve të tyre por edhe të tjerëve, si pjesë e aktivitetit dytësor të tyre të kryer në funksion të qëllimit të tyre jofitimprurës.

Organizatat pa qëllim fitimi nuk duhet të përdorin reklamat, të njohura si praktika të përdorura për arsye tregtare, të cilat u drejtohen personave joanëtarë për të reklamuar ose për të bërë të njohur veprimtarinë e organizatës. Nëse ato reklamojnë veprimtarinë e tyre, atëherë furnizimet e tyre nuk përfitojnë nga ky përjashtim.

Në kuadër të furnizimit të shërbimeve dhe mallrave ngushtësisht të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve, cilido qoftë personi juridik, ent publik, shoqatë, ndërmarrje, përjashtohen furnizimet e kryera nga institucionet që kujdesen për fëmijët e moshës deri në tre vjeç të cilat që në gjuhën e përditshme njihen "çerdhe".

IV. Për zbritshmërinë e TVSH-së

Organizatat jofitimprurëse që përfitojnë nga përjashtimi prej TVSH-së për furnizimet që ofrojnë në kuadër të veprimtarisë së tyre ekonomike, nuk kanë të drejtë të zbresin TVSH-në për mallrat dhe shërbimet e blera për qëllime të furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja.

V. Detyrimi për deklaratën e TVSH-së

Organizatat jofitimprurëse, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike, si veprimtari dytësore të tyre, edhe kur përfitojnë nga përjashtimi i TVSH-së sipas këtij vendimi detyrohen të bëjnë deklarimet për TVSH-në në afatet dhe formën që përcaktohet në ligj. Në deklaratën e TVSH-së do të deklarohen vetëm furnizimet e kryera në kuadër të veprimtarisë ekonomike si shitje dhe blerje të përjashtuara nga TVSH-ja.

VI. Nëse ndonjëri nga tri kriteret e përmendura në pikën II nuk plotësohet, atëherë furnizimet që kryen organizata nuk përfitojnë nga përjashtimi.

VII. Përfitojnë nga përjashtimi organizatat jofitimprurëse të cilat kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e përjashtuara nga TVSH-ja sipas ligjit, duke plotësuar të njëjtat kushte dhe kritere si personat fizikë dhe juridikë që kanë qëllime fitimi.

VIII. Organizatat, që përfitojnë nga përjashtimi për të paguar TVSH sipas këtij vendimi, përfitojnë gjithashtu nga përjashtimi i TVSH-së në import për mallrat në funksion të veprimtarisë së tyre jofitimprurëse.

Procedura për aplikimin e përjashtimit nga organizatat jofitimprurëse

1. Organizata jofitimprurëse, e cila kryen veprimtari ekonomike si veprimtari dytësore të saj dhe që plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 1, të këtij vendimi, që të aplikojë përjashtimin nga TVSH-ja për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve që kryen, detyrohet të kryejë procedurat e mëposhtme:

Paraqet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore ku është e regjistruar dokumentet e mëposhtme:

a) Vendimin e gjykatës (fotokopje e noterizuar);

b) Statutin e organizatës jofitimprurëse dhe kontratën e themelimit;

c) Një deklaratë në të cilën deklaron të listuara të gjitha shërbimet dhe mallrat që furnizon për anëtarët e saj ose për persona të tretë së bashku me çmimet që organizata aplikon për secilin furnizim;

ç) Një deklaratë ku shpreh misionin dhe qëllimin e OJF-së, si dhe identifikon programet kryesore të veprimtarisë;

d) Një deklaratë ku të deklarohet dhe të identifikohet kategoria e personave, grupeve në nevojë, të cilëve u shërben;

dh) Një deklaratë ku të specifikojë burimet e financimit të organizatës sipas zërave, përfshirë edhe të ardhurat e realizuara ose të pritshme nga veprimtaria ekonomike.

Në këtë deklaratë, organizata duhet të deklarojë në përqindje të përafërt të pjesës që zë ose pritet të zërë veprimtaria ekonomike e organizatës në raport me atë joekonomike. Kjo deklaratë kërkohet si në rastin kur organizata është regjistruar rishtas dhe nuk ka kryer më parë veprimtari ekonomike edhe në rastin kur ka kryer veprimtari bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare të dorëzuara në organin tatimor.

2. Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore ku është e regjistruar organizata ngre një grup pune (me 2 deri 3 punonjës), i cili shqyrton rastin bazuar në dokumentacionin e paraqitur, situatën që paraqet organizata, historikun e saj (nëse ka) si dhe çdo të dhënë tjetër që disponon.

3. Bazuar në rezultatet e verifikimit, kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 2, të këtij vendimi, brenda 25 ditëve pune, grupi i punës i paraqet një raport drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke i propozuar miratimin e përjashtimit nga TVSH-ja për furnizimet që kryen organizata.

4. Nëse gjykohet e nevojshme mund të kryhet edhe verifikim në vend i veprimtarisë së organizatës për llojet e furnizimeve të mallrave dhe shërbimeve të kryera dhe çmimet që aplikon për secilin furnizim. Edhe nëse verifikimi nuk kryhet paraprakisht ai mund të kryhet në çdo kohë prej autoritetit tatimor.

5. Në përfundim të procedurës, jo më vonë se 5 ditë pune, drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lëshon autoizimin për përjashtimin nga TVSH-ja. Nëse autorizimi refuzohet, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve jep arsyet, për të cilat përjashtimi nga TVSH-ja nuk mund të aplikohet prej organizatës.

6. Lëshimi i autorizimit për përjashtim nga TVSH-ja është i vlefshëm për 3 (tre) vjet, me të drejtë rinovimi. Për rinovimin e autorizimit për përjashtimin nga TVSH-ja ndiqet e njëjta procedurë, të njëjtat kushte dhe kritere si në rastin e përfitimit për herë të parë të autorizimit.

Për organizatat jofitimprurëse që regjistrohen për herë të parë, autorizimi i përjashtimit nga TVSH-ja është i vlefshëm për 1 (një) vit, me të drejtë rinovimi. Për rinovimin e autorizimit për përjashtimin nga TVSH-ja ndiqet e njëjta procedurë, të njëjtat kushte dhe kritere si në rastin e përfitimit për herë të parë të autorizimit.

7. Në rast se konstatohet se kushtet kanë ndryshuar më parë se afati i përcaktuar në pikën 6, të këtij neni, atëherë Drejtoria Rajonale Tatimore në çdo kohë ka të drejtë të rishqyrtojë përjashtimin nga TVSH-ja.

8. Nuk i nënshtrohen procedurës sipas këtij neni organizatat jofitimprurëse të cilat nuk kryejnë veprimtari ekonomike në kuadër të veprimtarisë jofitimprurëse dhe në përputhje me nenin 3, të ligjit, konsiderohen persona të patatueshëm për TVSH-në. Këta persona nuk regjistrohen për TVSH-në.

Gjithashtu, nuk i nënshtrohen kësaj procedure organizatat jofitimprurëse të cilat kryejnë veprimtari ekonomike të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit, si p.sh. shërbime shëndetësore, arsimore etj, në përputhje me përcaktimet në dispozitat ligjore.

Neni 4

Manifestimet e kryera nga organizatat jofitimprurëse për qëllime bamirësie ose mbështetje të shtresave në nevojë

1. Në zbatim në shkronjës "l", të nenit 51, të ligjit, furnizimi i shërbimeve dhe mallrave të kryera nga organizatat jofitimprurëse, veprimtaria e të cilave përjashtohet nga TVSH-ja, në raste të manifestimeve ose organizimeve për mbledhje fondesh ekskluzivisht për qëllime bamirësie ose në funksion të përmbushjes së qëllimit të veprimtarisë jofitimprurëse të organizatës, përjashtohen nga TVSH-ja nëse numri i këtyre manifesimeve ose organizmave nuk kalon 5 (pesë) të tilla në vit. Nëse organizohen më shumë manifestime të tilla, përjashtimi nga TVSH-ja aplikohet për të ardhurat e mbledhura vetëm për pesë manifestime.

Megjithatë pavarësisht nga numri, përjashtimi nuk aplikohet nëse organizimi i këtyre manifestimeve me pagesë dhe të hapura për publikun ka karakter të shpeshtë.

2. Përjashtimi nuk aplikohet për furnizimet e kryera nga personat fizikë ose juridikë tregtarë edhe nëse janë të autorizuar nga organizatorët e manifestimit, që të ushtrojnë për llogarinë e tyre disa veprimtari gjatë zhvillimit të manifestimit, të tilla si shitje produktesh të ndryshme, shfrytëzimi i stendave, bareve etj.

Neni 5

E drejta për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për qiradhënien e ndërtesës

1. Në zbatim të pikës 2 të nenit 55 të ligjit, personat e tatueshëm mund të ushtrojnë të drejtën të zgjedhin të aplikojnë dhe paguajnë TVSH për furnizimin e qiradhënies së ndërtesës duke e trajtuar atë jo si furnizim të përjashtuar, por si furnizim të tatueshëm me shkallën standarde të TVSH-së 20%.

2. Kjo e drejtë është e kufizuar dhe nuk mund të ushtrohet prej personave të tatueshëm që japin me qira ndërtesa (ambiente) për banim.

3. E drejta e zgjedhjes zbatohet për ndërtesa që qiramarrësit i përdorin për nevojat e veprimtarive të tyre të cilat përfshihen në fushën e zbatimit të TVSH-së, si veprimtari të tatueshme, ose të përjashtuara nga TVSH-ja, si dhe për veprimtaritë që ndodhen jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së.

4. Kur personi i tatueshëm ushtron të drejtën e zgjedhjes sipas pikës 1, të këtij neni, ai duhet të aplikojë zgjedhjen për çdo rast, përveç nëse qiramarrësi është një person i tatueshëm që kryen veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit. Në këtë rast, është kusht që në kontratën e qirasë të shkruhet e shprehur qartë zgjedhja e dëshiruar nga qiradhënësi dhe pranimi i saj nga qiramarrësi.

5. Në rastin kur e drejta e zgjedhjes ushtrohet që në fazën e ndërtimit të një ndërtese, duke plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë vendim, ushtrimi paraprak i së drejtës së zgjedhjes detyron qiradhënësin e ardhshëm që në deklaratën për zgjedhjen të përcaktojë, të identifikojë qartë ndërtesën (ambientet) /ndërtesat për t'u përdorur për veprimtari qiradhënieje të tatueshme.

6. Ndryshimi i qiramarrësit ose veprimtarisë së tij nuk cenon vlefshmërinë e zgjedhjes, me kusht që kontrata e re e qiradhënies, nëse kërkohet një e tille, e lidhur me një qiramarrës tjetër të përmbajë klauzolën që tregon se zgjedhja e aplikimit të TVSH-së është ushtruar nga qiradhënësi. Në rastin kur qiramarrësi i ri, një person i patatueshëm ose i përjashtuar nuk e pranon zgjedhjen, atëherë e drejta e

zgjedhjes për të aplikuar TVSH-në e humb fuqinë e saj dhe nuk mund të ushtrohet për ambientet përkatëse.

7. Në rastin kur autoriteti tatimor konstaton një situatë abuzimi ose mashtrimi, atëherë kjo përbën një arsye të forte për të rrëzuar zgjedhjen e aplikuar prej qiradhënësit.

8. Personat e tatueshëm që ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes duhet ta ushtrojnë atë në përputhje me këto kritere, si dhe modalitetet dhe rregullat e përcaktuara në nenet 6 dhe 7, të këtij vendimi.

Neni 6

Modalitetet dhe rregullat e ushtrimit të së drejtës për të zgjedhur aplikimin e TVSH-së për qiradhënien e ndërtesës

1. Personi i tatueshëm ushtron këtë të drejtë duke paraqitur më parë një deklaratë me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku deklaron se qiradhënia do të trajtohet si furnizim i tatueshëm. Kjo deklaratë e cila formalizon qëllimin e personit të tatueshëm për të futur në regjimin normal të TVSH-së, veprimtarinë e tij të dhënies me qira të ndërtesës, përmban të dhënat identifikuese për çdo ndërtesë të dhënë me qira, si dhe të dhënat e personit qiramarrës (emri, NIPT-i, adresa etj).

2. Për aplikimin e së drejtës së zgjedhjes është kriter domosdoshmëria e një kontrate noteriale midis qiradhënësit dhe qiramarrësit, në të cilën duhet të jetë shprehur qartë se palët bien dakord se qiradhënien do ta trajtojnë si furnizim të tatueshëm me TVSH. Personi i tatueshëm qiradhënës duhet të depozitojë, përveç deklaratës edhe kontratën e qirasë. Mungesa e kontratës së qirasë nuk i jep të drejtën e trajtimit të qiradhënies si furnizim i tatueshëm.

3. Në rast se qiradhënësi kryen furnizim qiradhënieje për subjekte të cilat ushtrojnë veprimtari të përjashtuara nga TVSH-ja sipas ligjit, qiradhënia trajtohet si furnizim i tatueshëm, vetëm në rast se në kontratën e qiradhënies, qiramarrësi është njohur me këtë fakt dhe ka pranuar të paguajë TVSH për qiranë. Në këtë rast, qiradhënësi duhet t'i bashkëlidhë deklaratës me shkrim edhe kontratën e qirasë. Mungesa e kontratës nuk i jep të drejtën e trajtimit të qiradhënies si furnizim i tatueshëm. Në këtë rast, qiramarrësi nuk mund të heqë dorë nga fakti që të paguajë TVSH për qiranë të paktën deri në përfundim të afatit të kontratës së qirasë.

Shembuj të qiradhënies për veprimtari të përjashtuar ose jashtë fushës së TVSH-së, ku qiradhënësi pavarësisht nga dëshira e shfaqur për të zbatuar zgjedhjen e TVSH-së, e ushtron të drejtën pasi ka rënë dakord me qiramarrësin:

Palët bien dakord paraprakisht për zbatimin e TVSH-së ose jo:

- të qiradhënies së një ndërtese për t'u përdorur si zyrë ku qiramarrës është një bashki që e përdor për pritjen e komunitetit të zonës, pra për një veprimtari të patatueshme me TVSH;
- të qiradhënies së një ndërtese (ambienti) për t'u përdorur si zyrë e dhënë me qira një zyre përfaqësimi, për nevoja të veprimtarisë së saj.

4. Në ndërtesat ose grupet e ndërtesave, ku përfshihen ndërtesa (ambiente) për të cilat qiradhënësi zgjedh të trajtojë qiradhënien e tyre si të tatueshme, por edhe ndërtesa (ambiente) të tjera për banim, e drejta e zgjedhjes nuk shtrihet te ndërtesat për banim, por zbatohet për të gjitha ndërtesat e tjera sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

Me grup ndërtesash kuptohet jo vetëm një grup ndërtesash që kanë qenë objekt i të njëjtit studim të terrenit, leje ndërtimi ose programi ndërtimi, të realizuar në një terren që i përket të njëjtit person, por edhe dy apo më shumë ndërtesave të ndërtuara në të njëjtin terren.

5. Zgjedhja nis ditën e parë të muajit në të cilin ajo formulohet. Pas fillimit të ushtrimit, zgjedhja zbatohet për aq kohë sa nuk ka qenë objekt ndërprerjeje.

Neni 7

E drejta e zbritjes kur ushtrohet zgjedhja

1. Në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së, për çdo ndërtesë ose grup ndërtesash që janë përfshirë për t'u trajtuar si të tatueshme ose për çdo ndërtesë ose grup - ndërtesash të cilat i jep me qira si të përjashtuara nga TVSH-ja, qiradhënësit duhet të evidentojnë veçmas zbritjet e TVSH-së për secilën nga ndërtesat ose grup - ndërtesat.

2. Gjithashtu, qiradhënësit që përveç veprimtarisë së qiradhënies ushtrojnë edhe veprimtari të tjera të tatueshme me TVSH ose jo, në lidhje me të drejtën e zbritjes së TVSH-së duhet t'i evidentojnë veçmas shpenzimet për secilën kategori të veprimtarisë.

3. Në rastin kur ndërtesa ose grupi i ndërtesave, për të cilin është kërkuar zgjedhja, përfshin ndërtesa (ambiente) për të cilat është ushtruar e drejta e zgjedhjes për t'i trajtuar të tatueshme me TVSH, në përputhje me dispozitat e ligjit, si dhe ndërtesa (ambiente) për të cilat nuk ushtrohet ose nuk është e lejuar të ushtrohet e drejta e zgjedhjes si ambiente për banim ose ambiente të dhëna me qira për nevojat e veprimtarisë së marrësve të patatueshëm ose të përjashtuar nga TVSH-ja të cilët në kontratën e qirasë nuk kanë formuluar shprehimisht të drejtën e zgjedhjes ose ambientet për përdorim profesional të cilat ende nuk janë dhënë realisht me qira (për to e drejta e zgjedhjes nuk mund të prezumohet për sa kohë që, sipas ligjit, qiradhënia mbi 2 muaj është furnizim i përjashtuar), TVSH-ja zbritet vetëm për tërësinë e ambienteve të përfshira realisht nga e drejta e zgjedhjes së TVSH-së.

4. Në lidhje me ushtrimin e së drejtës së zbritjes së TVSH-së, kjo zbritje lejohet për ndërtesën/at, të cilat edhe nëse nuk janë dhënë efektivisht me qira, por qiradhënësi, i cili i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe nëpërmjet elementeve objektive, vërteton se ai e jep me qira ambientin. Për këtë qëllim, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

-Kontrata të lidhura nga qiradhënësi apo çdo qasje tjetër ligjore të ndërmarrë prej tij dhe që vërteton përpjekjet e tij për të kërkuar qiramarrës për ndërtesat, ambientet për përdorim profesional të cilat kanë mbetur të lira (vakante);

-Ndërtesat, të cilat nuk janë ende objekt i një kontrate qiraje ose të një premtimi për qiradhënie në momentin e formulimit të zgjedhjes, duhet të përbëjnë një pjesë të vogël të tërësisë së ndërtesës ose ambienteve për përdorim profesional të ndërtesës në fjalë. Në çdo rast, ky kusht konsiderohet i përmbushur në rast se mungesa e qiradhënies së këtyre ambienteve që zënë një pjesë të vogël të ndërtesës justifikohet nga rrethanat ekonomike të pavarura nga vullneti i qiradhënësit, si p.sh.: fillimi i veprimtarisë së qiramarrësit, konjuktura të tregut imobiliar, fatkeqësi etj., të kësaj natyre.

5. Nuk kërkohet të bëhet rregullim i TVSH-së së zbritshme në situatat kur gjatë kohëzgjatjes së zgjedhjes konstatohet një mosdhënie me qira e përkohshme e ndërtesës, e justifikuar saktësisht nga rrethana ekonomike që nuk kanë të bëjnë me vullnetin e qiradhënësit. I tillë është rasti kur, për arsye të ndryshimit të qiramarrësit, gjatë periudhës në të cilën qiradhënësi kryen përpjekjet e nevojshme për gjetjen e një qiramarrësi të ri.

6. Nëse qiradhënësi ndodhet në një situatë ku ambientet mbeten të lira për një kohë të gjatë, më shumë se një vit, pra e drejta e zgjedhjes pavarësisht dëshirës së personit të tatueshëm nuk mund të ushtrohet ose nëse veprimtaria e qiradhënies së ndërtesës së personit të tatueshëm ndërpritet, ose si pasojë e refuzimit të rinovimit të kontratës, ose për shkak të pushimit të efekteve të zgjedhjes, ose heqjes dorë prej saj, atëherë personi i tatueshëm duhet të procedojë me rregullimin e TVSH-së së zbritur më parë, nëse ndërprerja e transaksioneve të tatueshme ndodh para fillimit të vitit të nëntë pas vitit kur fillon e drejta e zbritjes. Rregullimi i TVSH-së përkon me shumën e TVSH-së të zbritur më parë, e cila zvogëlohet me një të dhjetën për çdo vit, pas datës në të cilën ka përfunduar ndërtesa.

7. Në rastin kur zgjedhja përfundon ose periudha për të cilën ushtrohet zgjedhja është më e shkurtër se afati për të cilin ushtrohet e drejta e zbritjes së TVSH-së për pasurinë e paluajtshme, përfundimi i zgjedhjes sjell për pasojë detyrimin për rregullimin e TVSH-së së zbritur fillimisht nga personi i tatueshëm, nëse është rasti.

Neni 8

Përcaktimi i listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe procedurat e përjashtimeve e të kritereve përkatëse

1. Në zbatim të pikës 38, të nenit 56, të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja në import, makineritë dhe pajisjet që janë direkt të lidhura me investimin të kryera prej personave të tatueshëm të cilët:

a) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë të barabartë ose më të madhe se 50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë;

b) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e përpunimit aktiv pavarësisht nga vlera e investimit;

c) importojnë makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit;

ç) i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, të cilët importojnë makineri prodhuese në funksion të realizimit të kontratave të investimit të tyre;

d) në zbatim të pikës 41, të nenit 56 të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja importimi i makinerive bujqësore.

2. Importimi i makinerive dhe pajisjeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, vetëm në rastet kur të tilla makineri dhe pajisje importohen në funksion të realizimit të kontratave të investimeve dhe importuesi është vetë personi i tatueshëm që realizon investimin ose përdor makinerinë ose pajisjen. Personat e tatueshëm, që importojnë makineri dhe pajisje për shitje, nuk janë subjekte përfituese të përjashtimit nga TVSH-ja, me përjashtim të tatimpaguesve që importojnë makineri bujqësore sipas shkronjës "e", të pikës 1, të këtij neni.

3. Lista e makinerive dhe pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe makineritë bujqësore është e përcaktuar në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Personat e tatueshëm të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, të cilët importojnë makineri dhe pajisje për të përfituar përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar, duhet të pajisen me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja nga autoriteti doganor. Për marrjen e këtij autorizimi, subjektet duhet të paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dokumentet, si më poshtë vijon:

4.1 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

b) kopje të marrëveshjes me Këshillin e Ministrave, me anë të së cilës është miratuar kontrata e investimit, ku të jetë e specifikuar vlera e investimit e barabartë ose mbi 50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë (nëse ka një marrëveshje të tillë), ose, në raste të investimeve tërësisht private, kopje të lejes/licencës/autorizimit (vetëm për kërkesën e parë);

c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, ku të jetë e përcaktuar se vlera e investimit është e barabartë ose mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, si dhe kohëzgjatja e investimit;

ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;

d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe periudhën e instalimit;

dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;

e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj.

4.2 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

b) kopje të ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), ku të jetë specifikuar se aktiviteti ekonomik është në fushën e përpunimit aktiv. Verifikimi nëse ka ose jo autorizimin e lëshuar nga autoriteti doganor si tatimpagues në regjimin e përpunimit aktiv kryhet brenda

strukturave doganore;

c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për të gjithë kohëzgjatjen e investimit;

ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;

d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe për periudhën e instalimit;

dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;

e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj.

4.3 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

b) kopje të ekstraktit të QKR-së, ku të jetë specifikuar se aktiviteti ekonomik është në fushën e agrobiznesit;

c) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin dhe kohëzgjatjen e investimit;

ç) kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;

d) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen dhe për periudhën e instalimit;

dh) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të ambienteve ku do të bëhet investimi;

e) përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj;

4.4 Personat e tatueshëm të përcaktuar në shkronjën "d", të pikës 1, të këtij neni, paraqesin:

a) një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

b) vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore se importuesi është person i tatueshëm që i nënshtrohet regjimit të biznesit (ndërmarrjeve) të vogla dhe ushtron aktivitet prodhues;

c) kopje të ekstraktit të QKR-së;

ç) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive prodhuese që do të importohen dhe për periudhën e instalimit.

4.5 Në rastin e importit të makinave bujqësore, siç përcaktohet në shkronjën "e", të pikës 1, të këtij neni, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

Në rastin kur është fermer:

a) një kërkesë me shkrim, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore së cilës i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it me të cilën fermeri është pajisur nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila tregon se importuesi është fermer;

b) kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qira të tokës.

c) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinave që do të importohen dhe për periudhën e importimit.

Në rastin e tatimpaguesve të tjerë:

a) asnjë kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;

b) vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore se importuesi është person i tatueshëm;

c) kopje të ekstraktit të QKR-së;

ç) të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive bujqësore që do të importohen.

4.6 Importimet e makinerive e të pajisjeve të kryera në përputhje me pikat 38 dhe 41, të nenit 56, të ligjit, subjekt i këtij vendimi, të bëra me ndërmjetësimin e kompanive *leasing* janë subjekt i përjashtimit nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Subjektet përfituese duhet të paraqesin në doganë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Respektivisht sipas kategorisë, kopje të dokumentacionit të përcaktuar në pikat 4.1; 4.2; 4.3, 4.4 e 4.5 të këtij neni.

b) Kopje të kontratës me kompaninë *leasing*

5. Me plotësimin e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike, autoriteti doganor e pajis personin e tatueshëm me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja, në të cilin përcaktohet edhe dega doganore mbikëqyrëse. Nëse administrata doganore nuk përgjigjet brenda afatit 15-ditor, autorizimi konsiderohet i dhënë. Një kopje e autorizimit dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT). DPD-ja hap një regjistër të veçantë për importet që kryhen nga tatimpaguesit importues. Për çdo import të makinerive e të pajisjeve, personat e tatueshëm duhet të paraqesin kërkesat e parashtruara në këtë vendim për t'u pajisur me autorizim përjashtimi.

Neni 9

Përcaktimi i kategorive të operatorëve ekonomikë që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit

1. Në zbatim të pikës 38, të nenit 56, të ligjit, kategoritë e operatorëve ekonomikë, që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv janë personat e tatueshëm që kryejnë aktivitet të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në fushën e përpunimit aktiv, sipas përcaktimeve në "Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë". Nëse brenda 3 (tre) vjetësh nga momenti i marrjes së autorizimit të përjashtimit nga TVSH-ja, operatori ekonomik nuk ka kryer aktivitet përpunimi aktiv (import-rieksport mallrash nën regjimin e përpunimit aktiv), automatikisht duhet të paguajë tatimin e vlerës së shtuar, për të cilin ka përfituar përjashtimin përkatës.

2. Për zbatimin e përjashtimit nga TVSH-ja në import sipas këtij neni, kategoritë e operatorëve ekonomikë, që përfshihen në sektorin e agrobiznesit janë subjektet fizike ose juridike, që merren me prodhimin ose përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, të akuakulturës, peshkimit dhe pyjeve, si dhe prodhimin e përpunimin e imputeve bujqësore, si: fara, fidanë, plehra kimike, pesticide dhe medikamente veterinare:

2.1 Kategoritë kryesore të agrobiznesit janë:

a) kultivimi dhe prodhimi i produkteve bujqësore bazë, të tilla si të gjitha produktet bujqësore dhe blegtorale që vijnë direkt nga fusha apo stalla dhe që janë të papërpunuara, si p.sh.: frutat, perimet, patatet, drithërat, ullinjtë, mishi, peshku, qumështi, vezët, mjalti;

b) përpunimi i të gjitha produkteve bujqësore, të përmendura në shkronjën "a", të pikës 2.1, të këtij vendimi, të tilla si: lëngjet, kompostot, mielli, buka, vaji i ullirit, sallamrat, proshutat, peshku i përpunuar, të gjitha nënproduktet e qumështit etj.;

c) kultivimi, prodhimi apo përpunimi i produkteve pyjore, të tilla si: bimët dekorative, bimët aromatike-mjekësore, kërpudhat etj.;

ç) prodhimi dhe përpunimi i imputeve bujqësore, të tilla si: fara, fidanë, plehra kimike, pesticide;

d) mbarështimi i gjësë së gjallë, si: gjedhë, të imta, njëthundrakë, derra, shpendë, lepuj, bletë, kërmij, peshq, midhje.

Neni 10

Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së

1. Në zbatim të pikës 3, të nenit 77, të ligjit, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, përcaktohen kategoritë e eksportuesve, si më poshtë:

a) Personat e tatueshëm eksportues me risk zero, që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i) Vlera e eksporteve të bëra në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, përbën 100% të vlerës së përgjithshme të shitjeve përfshirë eksportet;

ii) Kanë aktivitet eksportues mbi 1vit;

iii) Paraqesin si dokument prove të kryerjes së eksportit deklaratën doganore të eksportit, lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë;

iv) Nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Këta persona të klasifikuar me risk zero rimbursohen automatikisht pa iu nënshtruar më parë analizës së riskut.

a) Personi i tatueshëm që i nënshtrohet regjimit të përpunimit aktiv për përpunimin në Republikën e Shqipërisë me qëllim rieksportimin e mallrave joshqiptare, siç përcaktohet në Kodin Doganor.

b) Personi i tatueshëm që eksporton mallra shqiptare sipas kuptimit të "Kodit Doganor i Republikës së Shqipërisë, nëse vlera e eksporteve të bëra në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursimi, përbën më shumë se 60% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet;

2. Të gjithë personat e tatueshëm eksportues sipas pikës 1, të këtij vendimi, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës duke iu nënshtruar procedurës së analizës së riskut, përveç eksportuesve të përcaktuar në pikën 1, shkronja "a", të këtij vendimi që klasifikohen me risk zero.

3. Të gjithë personat e tatueshëm që kryejnë eksporte, por nuk klasifikohen në pikën 1 t ketij neni, rimbursohen brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës duke iu nënshtruar procedurës së analizës së riskut.

Neni 11

Përcaktimi i kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)

1. Në zbatim të nenit 117, të ligjit, kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar është qarkullimi prej 5 milionë (pesë milionë) lekë në një vit kalendarik, përveç rasteve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni.

2. Personat e tatueshëm, që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, si dhe kryejnë veprimtari ekonomike në fushën e hotelerisë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në është zero dhe të gjithë janë persona të tatueshëm të regjistruar për TVSH-në, edhe nëse kryejnë veprimtari të përjashtuar sipas ligjit.

Neni 12

Organet zbatuese

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Neni 13

Shfuqizime

Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 179, datë 13.2.2013, "Për përcaktimin e kategorive të operatorëve ekonomikë që përfshihen në sektorin e përpunimit aktiv dhe të agrobiznesit", nr. 202, datë 9.4.2014, "Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve për eksportuesit për qëllim të rimbursimit të TVSH-së"; nr. 180, datë 13.2.2013, "Për përcaktimin e listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe të procedurave të përjashtimeve e të kritereve përkatëse", të ndryshuar"; nr. 178, datë 13.2.2013, "Për përcaktimin e procedurave, kritereve, llojit dhe sasisë së përjashtimeve nga tatimi mbi vlerën e shtuar, në import dhe brenda vendit, për produktet hekur dhe çimento për ndërtimin e hidrocentraleve"; nr. 1058, datë 21.10.2009, "Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH)", i ndryshuar; nr. 1679, datë 24.12.2008, "Për kriteret dhe procedurat e përcaktimit të

statusit të organizatave jofitimprurëse, për përfitim publik", dhe nr. 559, datë 16.8.2006, "Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike të importuar nga KESH, sh.a.", i ndryshuar, shfuqizohen.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama